

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/01;
Datë: 17.01.2019 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Muharrem Krasniqi – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: mbledhja e njëmbëdhjetë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 28.01.2019, ora 14⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor i punës së Kuvendit Komunal për vitin 2018,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor i punës i Komitetit për Komitete për vitin 2018,
4. Fillimi i procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale të Komunës,
5. Të ndryshme



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

REFERENC-Ë:	Numër: 11– 11/18
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Muharrem Krasniqi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	28.12.2018
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së kuvendit të komunës së Junikut, KK- Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së njëmbëdhjetë të rregullt të kuvendit të komunës së Junikut me datë: 28.12.2018, në ora 14:00, në sallën e KK-Junik. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Muharrem Krasniqi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Junikut, i cili fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës së Junikut z. Agron Kuçi, Nënkryetarin z. Faik Tofaj, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Anëtarët e Kuvendit Komunal – Junik, dhe qytetarët e pranishëm.

Anëtarët prezent:

- | | |
|-------------------------------------|---------------------------------|
| 1. Muharrem Krasniqi -kryesues, AAK | 6. Albert Gjocaj – anëtar, AAK |
| 2. Behare Qestaj – anëtare, AAK | 7. Dardane Shala – anëtare, AAK |
| 3. Sindije Idrizi – anëtare, AAK | 8. Tahir Isufaj – anëtar, LDK |
| 4. Betim Gacaferi – anëtar, AAK | 9. Zeqë Hebibi – anëtar, LDK |
| 5. Xhemë Tofaj – anëtar, AAK | 10. Edona Shehu – anëtare, LDK |

11. Luljeta Jasiqi – anëtare, VV

13. Zenel Maloku – anëtar, i pavarur

12. Kreshnik Maloku - anëtar, PDK

Munguan z. **Lulzim Gacaferi** – anëtar, VV, znj. **Erleta Isufaj** – anëtare, LDK

Kryesuesi z. Muharrem Krasniqi - AAK: konstatoj se në sallë janë gjithsej 13 asamblesit, pra mund të fillojmë mbledhjen e njëmbëdhjetë të rregullt të Kuvendit Komunal. Asambleistja znj. Erleta Isufaj na ka njoftuar se nuk mund të merr pjesë në këtë mbledhje për arsye pune.

Kemi edhe tri pika/kërkesa të reja përveç atyre që ju kanë ardhur

1. Kërkesë nga Kryetari i Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës,
2. Kërkesë nga Isuf Hebibi për dhënien e lejes së ndërtimit për objektin e tij,
3. Kërkesë nga Kryetari i Komunës për ndarjen e çmimit Kuvendi i Junikut, për heronjë të Kosovës, Edmond Hoxha, Zahir Pajaziti dhe Hakif Zejnullahu

z. Muharrem Krasniqi: i jap fjalën Drejtorit të Urbanizmit për kërkesën e parë dhe të dytë, për këto kërkesa nuk ka diskutime vetëm votohet për to

z. Hasan Krasniqi: me KAB planifikojmë asfaltimin e rrugës Junik – Dranoc, bëhet fjalë për një pjesë mbi lagjen Agim Ramadani, për investitorin Florim Shala ku i kemi jep miratim për ndërrim të kulturës. Bëhet fjalë më tepër për rregullim të kufirit, një rrugë që ka qenë me gjerësi 4 metra, po planifikohet me u drejtu dhe me u zgjeru 12 metra ka me qenë e gjatë. Për pikën apo kërkesën e dytë, arsyeja pse nuk ju ka dhënë leja e ndërtimit kanë qenë dy pika që i ka planifiku ky kuvend me planin rregullues për pjesën e qendres, meqenëse ky kuvend i ka planifiku ato pika, ky kuvend ka kompetenc me i ndryshu ato pika, kërkesa jonë është me e miratu lejen e ndërtimit, duke e fut aty që ndryshohet plani rregullues për atë pjesë, ngritet përqindja e shfrytëzimit të hapësirës dhe zvogëlohet vija e ndërtimit.

z. Muharrem Krasniqi i votojmë këto pika veç e veç për të hyrë në rend dite, kush është për kërkesën e parë konstatoj se me 10 vota për, 3 kundër, 0 abstenime hin si pikë. Për pikën e dytë kërkesa nga Isuf Hebibi për lejen e objektit e hedh në votim për pikë të rendit të ditës dhe konstatoj se me 13 vota për, 0 kundër, 0 abstenime hin si pikë e rendit të ditës. E hedh edhe pikën e tretë në votim dhe konstatoj se me 12 vota për, 0 kundër, 1 abstenim hin si pikë e rendit të ditës. Pra që të trija këto kërkesa hyjnë si pika të rendit të ditës

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt – Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2019,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim – Vendimit për orarin e mbajtjes së mbledhjeve dhe takimeve të Kuvendit Komunal në Junik për vitin 2019,
4. Fillimi i procedurave për hartimin e Planit për Integritet,
5. Kërkesë nga Kryetari i Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës,
6. Kërkesë nga Isuf Hebibi për dhënien e lejes së ndërtimit për objektin e tij,
7. Kërkesë nga Kryetari i Komunës për ndarjen e çmimit Kuvendi i Junikut, për heronjë të Kosovës, Edmond Hoxha, Zahir Pajaziti dhe Hakif Zejnullahu
8. Të ndryshme

Znj. Behare Qestaj: ne pajtohemi me këto pika të rendit të ditës

z. Tahir Isufaj: dakord

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim, konstatoj se rendi paraprak i ditës miratohet me 13 vota për, 0 kundër, 0 abstenime

I

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

z. Muharrem Krasniqi: a ka dikush diçka rreth procesverbalit

z. Tahir Isufaj: janë disa lëshime por e pranojmë edhe kështu, diçka konkrete nuk kam

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 13 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon procesverbali

II

2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt – Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2019

z. Muharrem Krasniqi: kjo pikë e ka kalu leximin e parë, është në të dytin

znj. Kosovare Gacaferi: pas mbledhjes së KPF-së dhe Kuvendit kjo rregullre është hedhur në diskutim publik, nga data 09.11.2018 deri 23.11.2018, ku e keni të bashkangjitur raportin nga diskutimi publik. Ne kemi mbajtur edhe takimin final për të diskutuar lidhur me sugjerimet e dala nga mbledhja e KPF-së dhe mbledhja e Kuvendit dhe u pajtuam që të ndodhin disa ndryshime si vijon: në drejtorinë për administratë të përgjithshme fq 4, neni 5, pika 1.10 është bërë nga 3 në 2 euro, pika 1.12 nga 3 në 2 euro, pika 6.2 nga 5 në 3 euro dhe pika 6.3 nga 5 në 3 euro. Në drejtorinë për shëndetësi në faqe 9 pika 18,19,20,21 janë shërbime administrative dhe nuk lirohen pacientët nga pagesa për këto shërbime. Në drejtorinë për shërbime publike në faqe 11 është shtuar pika 2.10 vazhdimi i lejës për autobus në vlerë 40 euro, në faqe nr 16 është shtuar

pika 15.8 mospaisja e ekonomive familjare me kontenjer të mbeturinave në vlerë 50 euro, në faqe nr 18 pika 27.1 nga 50 euro është bërë 70 euro, në faqe 27 neni 10 meqenëse është shfuqizuar udhëzimi administrativ nr 14/2015 dhe ka hyrë në fuqi U.A nr 06/2018, meqenëse i ka kalu krejt këto procedura besoj që sot e meriton miratimin nga ana e juaj

znj. Behare Qestaj: e falenderoj drejtoreshën që sugjerimet të cilat i kanë jep anëtarët e kuvendit i ka marrë parasysh, ne si grup e kemi votu edhe më herët jemi për miratimin e kësaj rregullore

z. Tahir Isufaj: pajtohem

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 13 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon

III

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim – Vendimit për orarin e mbajtjes së mbledhjeve dhe takimeve të Kuvendit Komunal në Junik për vitin 2019

z. Muharrem Krasniqi: këtë orar e kam dërguar edhe te drejtorët e drejtorive, përveç vërejtjes që kam marrë nga Kryetari i Komunës e cila do të mbahet me 30 janar e mërkurë, sepse me 31 janar pritet me u mbajtë mbledhje solemne me rastin e rënies së 3 heronjëve të Kosovës, pra mbledhja e parë parashihet me 30 janar, a keni ndonjë vërejtje

z. Tahir Isufaj: janë 4 të enjte, ora mbetet e njejtë nuk ka problem.

z. Muharrem Krasniqi: kalendari është ashtu, dy data na i ka kërku drejtoresha e Financave, sepse ka me i dërgu materialet brenda muajit në Prishtinë. Po ora mbetet e njejtë në ora 14:00, e hedh në votim dhe konstatoj se me 13 vota për, 0 kundër, 0 abstenime kalon kjo pikë

IV

4. Fillimi i procedurave për hartimin e Planit për Integritet

znj. Leonita Jasiqi: Në raportin e fundit të MAPL-së, për përmbushjen e obligimeve të Komunave nga agjenda Evropiane, Komunës së Junikut i jepen dy rekomandime, njëri ndër to është hartimi i planit për Integritet, andaj me qëllim të përmbushjes së këtij rekomandimi, Drejtoria për Administratë të Përgjithshme e ka pa të arsyeshme dhe të domosdoshme që t'u drejtohet juve, me një kërkesë. Kërkesa në fjalë e ka bazën ligjore në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Gazetën Zyrtare, Statutin e Komunës së Junikut dhe Raportin e Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal, andaj kërkojmë votën tuaj në mënyrë që të hartohet ky Plan i Integritetit dhe të plotësohet edhe një kriter nga ana e Komunës së Junikut.

Znj. Behare Qestaj: ne si grup e përkrahim fillimin e procedurave për planin e Integritetit

z. Tahir Isufaj: po thoni çdo herë që ju ka mbet edhe një kritet me e plotësu, kërkesa kryesore për Komunën e Junikut, administratën komunale e qytetarët e Junikut është emërtimi i rrugëve e shesheve, pse nuk është kry deri tash

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 10 vota për, 0 kundër, 3 abstenime kalon

V

5. Kërkesë nga Kryetari i Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës

z. Muharrem Krasniqi: Kryetari i Komunës ka bërë kërkesë për këmbimin e pronës, këtu është ligji dhe nenet në të cilat është thirrë Kryetari i Komunës, nga parcela 5051 të pronës së Komunës bashkangjitur e gjeni kopjen e planit. Ju ka ardhë me material shtesë

z. Hasan Krasniqi: në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore, planifikojmë ndërtimin e rrugës që ka me e lidh Junikun me Dranoc, pronarët që janë fqinjë aty kanë tregu gadishmëri me na ofru vet 25 ari për me e drejtu atë rrugë dhe me e zgjeru, pjesa jonë që kërkojmë me u marr vendimi me u këmbi është prej 7 ari, pasi të përfundon krejt kjo ngjyra e gjelbër ka me qenë pjesa që ka me ju dhënë Komuna, ndërsa ngjyra e kuqe ka me qenë prona që ka me e përfitu Komuna. Ka me qenë rruga 12 metra e gjerë.

z. Tahir Isufaj: kush po dëmtohet, çka i duhet Junikut ajo rrugë

z. Hasan Krasniqi: po këmbehet me Florim Shalën prona, ne ja kemi ndrru kulturën e tokës për atë pjesë, është ka ndërtohet nje lagje aty, kuvendi e ka marrë vendimin

znj. Behare Qestaj: ne si grup e përkrahim këtë kërkesë

z. Tahir Isufaj: nuk është në rregull, kush e bën rrugën

z. Zenel Maloku: është në pyetje atje të lagjja, nëse atje bëhet një lagje për banim të njerëzve, unë e di që është e nevojshme edhe rruga me u bo. Sikur është bërë asfaltimi i të gjitha lagjeve të Junik, duhet t'i bëhet edhe asaj lagje sipas mendimit tim është shumë e drejtë me ju bo.

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim dhe konstatoj se me 10 vota për, 1 kundër, 2 abstenime kalon

VI

6. Kërkesë nga Isuf Hebibi për dhënien e lejes së ndërtimit për objektin e tij

z. Muharrem Krasniqi: është kërkesa nga Isuf Hebibi, bashkangjitur e gjeni kërkesën që i ka bo Kuvendit Komunal, është edhe plani i ndërtimit me dokumente përkatës, kërkon që t'i jepet leja ndërtimore, është edhe cerfitikata e pronësisë

z. Agron Kuçi: në praktikën të deritashme qeveria komunale e Junikut, e ka përkrahë çdo kategori të qytetarëve të Junikut, ne deri tani nga Asambleja kemi dhënë pëlqimin edhe për zonat ekonomike edhe për të gjitha bizneset. Kjo kërkesë vjen nga afaristi Isuf Hebibi, i cili ka një projekt afaristo- banesor, por për shkak të disa kufizimeve, kemi qenë të kufizuar, unë kërkoj nga ju që të shqyrtohet kërkesa e të lartë cekurit dhe nga ju të vendoset për dhënien e lejes për këtë objekt banesor

z. Hasan Krasniqi: arsyet e vetme për të cilat është refuzu kjo leje kanë qenë, sepse ka ra në kundërtshim me dy pika të planit rregullues që i kemi për atë pjesë, plan të cilin e ka miratu ky kuvend dhe është kompetencë e tij që ato dy pika me i ndryshu, bëhet fjalë për koeficientin e shfrytëzimit të sipërfaqes nga 50% në 75 % me qenë objekt dhe për vijën ndërtimore, është objekt që në të gjitha parametrat e tjerë përputhet me planin rregullues urban për zonën qendër. Kërkojmë nga ju që këto dy pika të ndryshohen për atë parcelë dhe të jepet mundësia për dhënien e lejes së ndërtimit këtij objekti, projektin e kam përpara me krejt dokumentacionin tjetër.

znj. Behare Qestaj: ne e përkrahim këtë kërkesë, vetëm sugjeroj që çdo herë qytetarët t'u përmbahen pikave që i kërkon planin rregullues urban

z. Tahir Isufaj: kish me qenë keq nëse dikuj i cenohet një mundësi e tjerëve ju lejohet, të gjithë në qendër janë jashtë normave qoftë me naltësi apo hapësirë, pse me ja ndalu këtij

z. Zenel Maloku: ne duhet me qenë të kënaqur me atë objekt dhe mirë është me e votu

z. Muharrem Krasniqi: e hedh në votim, marrin pjesë 12 anëtarë sepse Zeqa nuk mundet të votoi këtë pikë, konstatoj se 11 vota janë për, 1 abstenim, 0 kundër

VII

7. Kërkesë nga Kryetari i Komunës për ndarjen e çmimit Kuvendi i Junikut, për heronjë të Kosovës, Edmond Hoxha, Zahir Pajaziti dhe Hakif Zejnullahu

z. Agron Kuçi: në traditën e Komunës së Junikut, në përvjetore të ndryshme është që të ndajë mirënjohje e shpërblime të ndryshme, i kemi nda për disa personalitete dhe familje të shquara të historisë kombëtare. Çmimi "Kuvendi i Junikut", në mesin e atyre familjeve ka qenë familja Jashari, Haradinaj, Rugova etj. Është në organizim e sipër një akademi përkujtimore, në një vit jubilar të shënimit të përvjetorit të rënies së Heronjëve Edmond Hoxha, Zahir Pajaziti dhe Hakif Zejnullahu, nën patronatin e Kryeministrit të Kosovës, me datë 31.01.2019, konsideroj që kjo asamble duhet t'i nderojë dhe t'u jep mirënjohjen "Kuvendi i Junikut", këtyre heronjëve të UÇK-së.

znj. Behare Qestaj: e përkrahim këtë propozim, janë heronjë të cilët e meritojnë

z. Tahir Isufaj: ishte dashtë me bisedu pak më shumë me e kqyrë kuj ti jepet, ne kemi edhe heronjë tonë

z. Muharrem Krasniqi: mund të bëhen propozime në Kuvend, e hedh në votim dhe konstatoj se me 12 vota për, 0 kundër, 1 abstenim miratohet

VIII

8. Të ndryshme

z. Tahir Isufaj: e pash në kalendarë është dashtë me e qit ndonjë objekt apo punë që është bërë, i pash disa fotografi tjera nuk është në rregull

z. Muharrem Krasniqi: me kaq e mbylli këtë mbledhje

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:45

Procesmbajtës:

z. Turim Ganiqaj

Kryesues i Kuvendit:

z. Muharrem Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Referencë:	Numër: 2-358/19
Për/Za/To:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut
Nga/Od/From:	z. Muharrem Krasniqi - kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut
Datë/Datum/Date:	08.01.2019
Tema/Subjekat/Subject:	R A P O R T P U N E

Vendi: Komuna e Junikut

Hartuesi: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut

Lloji i punës: Raport pune

“RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2018”

Junik, janar 2019

Kuvendi i Komunës së Junikut në përputhje me obligimet që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës së Junikut, Rregullorja e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe ligjet e tjera në Republikën e Kosovës, për vitin 2018 harton këtë:

RAPORT PUNE

Kuvendi i Komunës së Junikut është organi më i lartë i themeluar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (neni 35).

Kjo është legjislatura e pestë e këtij organi e dalë nga zgjedhjet lokale 2017.

Kuvendi i Komunës së Junikut numëron gjithsejtë 15 anëtarë prej të cilëve 9 janë meshkuj dhe 6 femra. Në kuvend janë të përfaqësuara katër subjekte politike: AAK me 7 këshilltarë; LDK me 4 këshilltarë; LVV me 2 këshilltarë dhe PDK me 1 këshilltarë dhe 1 i pavarur.

Përveç Kuvendit si organ ligjvënës në kuadër të tij janë të themeluara edhe trupa ndihmës siç janë komitetet dhe komisionet. Deri më tash janë të themeluara 2 komitete (dy të përhershme Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete), Komiteti konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, 3 komisione (Komisioni për Emërtimin e Zonave të Qarkullimit Publik, Komisioni (paneli) për përzgjedhjen e anëtarëve të Komiteteve konsultative dhe Komisioni Vlerësues për Dhënie dhe Pronë të Paluajtshme Komunale në Shfrytëzim.

Për të gjitha çështjet tjera siç janë dërgimi i materialit, arkivimi si dhe evidentimi protokollar i të gjithë materialit të kuvendit është punuar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ MAPL) Nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Statutin e Komunës së Junikut dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut duke respektuar aq sa ka qenë e mundur Planin e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2018.

Gjatë vitit 2018 Kuvendi i Komunës së Junikut ka mbajtur gjithsejtë 11 mbledhje të rregullta dhe 1 mbledhje solemne (17 Shkurti Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës) derisa mbledhje të jashtëzakonshme dhe mbledhje urgjente nuk janë mbajtur për arsye se për të tilla mbledhje nuk është paraqitur nevoja.

Pothuajse në të gjitha mbledhjet ka mbizotëruar fryma e arsyes dhe janë trajtuar çështje të rëndësishme për komunën e Junikut.

Komitetet e përhershme (Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete) gjatë vitit 2018 kanë mbajtur gjithsejtë 10 mbledhje të rregullta sipas planeve të miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut, Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsejtë 6 mbledhje kurse Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur gjithsejtë 5 mbledhje të rregullta.

Puna e komisioneve të ngritura nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut do të pasqyrohet në raportin e punës së secilit komision veç e veç.

RREGULLORET:

Kuvendi i Komunës së Junikut për vitin 2018 ka miratuar gjithsejtë 4 rregullore.

1. Rregulloret e miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut në vitin 2018 janë:
 - 1.1. Rregullorja e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut;
 - 1.2. Rregullore për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve;
 - 1.3. Rregullore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019;
 - 1.4. Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

BUXHETI:

Shpenzimet e bëra nga Kuvendi Komunal në Junik në periudhën Janar-Dhjetor 2018

Mjetet e alokuara në këtë kategori shpenzuese janë në shumë prej 53,769.24 €, ku nga kjo shumë janë shpenzuar mjetet në vlerë prej 53,764.79 € marrë në përqindje mjetet e shpenzuara nga kjo kategori shpenzuese arrijnë një përqindje prej 99.99%. Në këtë kategori hyjnë shpenzimet e Pagave dhe mëditjeve në shumë prej 50,269.24.

Pagat dhe mëditjet në shumë prej 50,269.24€

Në Kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë bërë këto shpenzime :

Shpenzimet telefonike në shumë prej 361.55 për telefonin e kryesuesit të kuvendit

Te shërbimet tjera kontraktuese në shumë prej 173.22 shpenzimet janë bërë për shërbimet e printimit

Shpenzimet furnizim për zyrë janë bërë në shumë prej 637.50

Shuma prej 1,581.75, për derivate për Ngrohje të objektit të komunës

Shuma 527.25 derivate për gjenerator

Si dhe shuma prej 214€ Dreka zyrtare

		16920	
Kodet eko.	PAGAT & MEDITJET	Zyra e Kuvendit	Planifikimi
11110	Paga Neto	44,052.36	

11500	Tatimi në të ardhura personale	1,467.40	
11600	Kontributi Pensional I punëtorit	2,374.74	
11700	Kontributi Pensional I punëdhënësit	2,374.74	
	Gjithsej :	50,269.24	50,269.24
	MALLRAT DHE SHËRBIMET	3,495.55	
13320	Shpenzime tjera telefonike	361.83	
13460	Shërbime kontraktuese tjera	173.22	
13610	Furnizime për zyrë	637.50	
13720	Naftë për ngrohje qendrore	1,581.75	
13770	Derivate për gjenerator	527.25	
14310	Drekat zyrtare	214.00	
	Gjithsej :	3,495.55	3,500.00
	Gjithësej €	53,764.79	53,769.24

Përveç kësaj gjatë vitit 2018 Kuvendi i Komunës së Junikut ka nxjerrë gjithsejtë 45 akte. Nuk ka nxjerrë asnjë rekomandim dhe asnjë njoftim për arsye se për të njëjtat nuk është bërë asnjë kërkesë.

Në vijim në mënyrë tabelore po paraqesim aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Junikut në vitin 2018.

AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2018

Rreg.	Mbledhjet e Kuvendit te Komunes			Aktet e KK		Komitetet e përhershme		Raporti i Kryetarit	Takimet publike	Takimet e KKSB	Komitetet e tjera	Komitetet konsultative
	Jashtë...	Sole...	Urgj..	Rre...	Ven...	KPF	KK	Numeri i raportimit	Numeri i takimeve	Numeri i takimeve	Emri i komiteve	Emri i komiteve
11	0	1	0	4	41	10	6	2	2	5		

Përfundim:

Në këtë raport pune janë pasqyruar një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut, por kurrësi nuk mund ta konsiderojmë si të plotë, pasi që nuk kanë mundur të pasqyrohen edhe aktivitetet e trupave ndihmës të Kuvendit të Komunës së Junikut për shkak të mungesës së raporteve të punës së tyre .


Përfundimisht Kuvendi i Komunës së Junikut në vitin 2018 ka funksionuar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Statutin e Komunës së Junikut dhe Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut ka bashkëpunuar me ekzekutivin sa u përket respektimit të procedurave ligjore lidhur me shqyrtimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike komunale.

Me këtë rast në emër të Kuvendit të Komunës së Junikut Ju falënderoj të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Junikut për kontributin e dhënë deri më tash.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Muharrem Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Vendi: Komuna e Junikut

Hartuesi: Komiteti për Komunitete

Lloji i punës: Raport pune

**“RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
PËR VITIN 2018”**

Junik, janar 2019

Komiteti për Komunitete me qëllim të realizimit të detyrave të punës në përputhje me Rregulloren e Punës së Komiteteve të Komunës së Junikut dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale për vitin 2018 harton këtë:

RAPORT P U N E

Hyrje:

Komiteti për Komunitete është organ i formuar nga Kuvendi i Komunës së Junikut në harmoni me Statutin e Komunës së Junikut dhe Rregullores së punës së Kuvendit.

Misioni:

Siç është përshkruar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Komiteti për Komunitete është përgjegjës për të trajtuar çfarëdo çështje që ka të bëjë me diskriminimin e një personi mbi çfarëdo baze siç është: gjuha, religjioni, prejardhja etnike, dhe çdo çështje tjetër që lidhet me interesin e një komuniteti.

Komiteti për Komunitete numëron gjithsej 4 anëtarë prej të cilëve 2 janë femra dhe 2 meshkuj, në komitet është një përfaqësues i subjektit politik AAK, një anëtarë i pavarur, një përfaqësues i subjektit politik PDK, një përfaqësues i subjektit politik VV, dhe mungon një përfaqësues nga subjekti politik LDK.

Gjatë vitit 2018 Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsej 6 mbledhje të rregullta. Pothuajse në të gjitha mbledhjet ka mbizotëruar fryma e arsyes dhe janë trajtuar çështje të rëndësishme për komunitetet e Junikut.

Muaji:	Numri i mbledhjeve:	Aktivitetet:
03.07.2018	Mbledhja e parë e rregullt e Komitetit për Komunitete	1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Komunitete
23.07.2018	Mbledhja e dytë e rregullt e Komitetit për Komunitete	2. Shqyrtimi i projekt (rregullores) për Tatimin mbi Pronën e paluajtshme për vitin 2019. (Leximi i parë) 3. Gjendja e pyjeve të Junikut në sezonën verore (prerje ilegale, rreziku nga djegjet, pastërtia).
21.09.2018	Mbledhja e tretë e rregullt e Komitetit për Komunitete	Shqyrtimi i planit të punës së Kuvendit Komunal të

		Junikut për vitin 2019; 3. Informatë rreth sigurisë në Junik; 4. Caktimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Komitetit për Komunitete.
24.10.2018	Mbledhja e katërt e rregullt e Komitetit për Komunitete	Shqyrtimi i propozim-Vendimit për themelimin e panelit përzgjedhës të anëtarëve të komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Junikut; 3. Informatë lidhur me funksionimin e ndriçimit publik në komunën e Junikut.
22.11.2018	Mbledhja e pestë e rregullt e Komitetit për Komunitete	Kërkesë për nxjerrjen e rregullores për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë negative;
25.12.2018	Mbledhja e gjashtë e rregullt e Komitetit për Komunitete	Suksesi dhe realizimi i planit shkollor me rastin e përfundimit të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor; 3. Informatë rreth punës së performancës së punëtorëve për mirëmbajtjen e higjienës në shkollën fillore dhe gjimnaz; 4. Informatë rreth disponimit të mjeteve dhe paisjeve bazë për zhvillimin e rregullt të mësimin në shkollën fillore dhe gjimnaz.

Përfundim:

Në këtë raport pune janë pasqyruar një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve të Komitetit për Komunitete.

Komiteti për Komunitete:

Dardane SHALA

Kryesuese



04-180-255

11.01.2019



RËPUBLIKA E KOSOVËS – RËPUBLIKA KOSOVA – RËPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	11.01.2019
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Muharrem Krasniqi-Kryesues i Kuvendit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Agron Kuçi - Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Krasniqi-drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë

Në bazë të Nenit 3, 10.15 dhe 16 të Ligjit Për Planifikim Hapësinor me nr. 04/L-174 të datës 31 korrik 2013, nenit 9 të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale, kërkojmë nga ju miratimin e Vendimit për Hartimin e **Planit Zhvillimor Komunal** dhe **Hartën Zonale të Komunës**. Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal dhe hartës Zonale të Komunës bëhet me qëllim harmonizimin e Planeve Zhvillimore Komunale me Legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës dhe nxitjen e Zhvillimit në territorin e Komunës së Junikut.

Ju faleminderit për bashkëpunim!